

Solidarë në shoqëri – të fortë në ndërmarrje

Shtojca për Kongresin e Unia 2016 nga 27 deri më 29 tetor në Gjenevë

Ne përcaktojmë kursin

Kongresi si organi më i lartë i Unia do të përcaktojë kahen strategjike të sindikatës për katër vjetët e ardhshëm.

2

Ne zgjedhim ardhmërinë

Kongresi do të zgjedhë udhëheqësinë e Unia. Shtatë anëtarët e deritashëm do të kandidohen sërish për të udhëhequr Unia në periudhën e ardhshme midis kongreseve.

2-3

Ne jemi Unia

Sindikata më e madhe dhe më luftarake në Zvicër mund të kthejë kokën prapa me krenari në katër vite të rëndësishme. Ne kujtojmë disa nga pikat kulmore.

4



Solidarë në shoqëri – të fortë në ndërmarrje!

Dymbëdhjetë vjet pas krijimit të sindikatës sonë, ne mund të konstatojmë me kënaqësi: Unia është konsoliduar si sindikatë e fortë luftarake. Ne formësojmë marrëdhëniet e punës dhe temat e ndryshme shoqërore dhe politike e ekonomike dhe mbrojmë interesat e punëmarrësve. Ne kemi përmirësuar shumë kontrata të punës ose kemi përfunduar kontrata të reja. Angazhimi i Unia për të punësuarit

gjatë pesë vjetëve po reflektohet me rritje të anëtarësisë. Me mbi 200000 anëtarë, Unia është sindikata më e madhe në Zvicër. Në Kongresin e katërt të Unia në Gjenevë, ne do të bëjmë bilancin e përbashkët për periudhën e kaluar midis dy kongreseve. Ne do të përcaktojmë strategjinë organizative dhe pozicionin për punën tonë të ardhshme si dhe do të zgjedhim organet drejtuese. Kështu ne do të vëmë bazën për përparime të mëtejme: Ne duam të vazhdojmë me rritjen e anëtarësisë, të forcojmë rrjetin e njerëzve të besueshëm, të përmirësojmë aftësinë mobilizuese, të for-

cojmë lidhjet tona në ndërmarrje dhe të vëmë në veprim më mirë burimet tona. Solidarë në shoqëri – të fortë në ndërmarrje: Kjo është motoja e kongresit tonë të katërt. Këtë qëllim ne duam ta arrijmë edhe më shumë në të ardhmen. Ne gjendemi para sfidave të mëdha. Teknologjitë e reja po e revolucionarizojnë botën e punës. Vlerat, marrëdhëniet shoqërore, e bashkë me to e tërë shoqëria, po ndryshojnë. Detyrat tona të shumanshme ne mund t'i kryejmë me sukses, vetëm nëse ne jemi të bashkuar dhe ofrojmë përgjigje së bashku. Vendimtar për këtë janë anëtarët, të cilët, për

çdo ditë, në ndërmarrje, në udhëheqje dhe në aksione, bëjnë një punë madhështore. Me angazhimin e tyre të palodhshëm, ata janë forca e Unia.

Në katër vitet e ardhshme, neve na pret shumë punë. Falë juve, falë njerëzve tanë të besueshëm dhe aktivë dhe falë bashkëpunëtorëve tanë të angazhuar, ne mund t'u rrekemi detyrave të sigurtë. Unia – jemi ne, të bashkuar.

Vania Alleva, Kryetare e Unia



Kongress
Congrès
Congresso 2016

UNIA

Ta mendojmë ardhmërinë

Në lidhje me Kongresin 2016 Unia ka lansuar një diskutim për të ardhmen. Qëllimi është një debat i hapur për vizionet e përbashkëta shoqërore dhe për një punë sindikale të orientuar kah e ardhmja.

Diskutimi për të ardhmen do të përfshijë edhe njerëzit e besueshëm të Unia nga të gjitha rajonet. Tubime të shumta janë mbajtur në tërë Zvicrën, gjatë dy vjetëve të fundit.

Një tubim që duhet veçuar ishte punëtorja e zhvilluar në Kuvendin e delegatëve më 5 dhjetor 2015. Njerëzit e besueshëm dhe përfaqësuesit e rajoneve si dhe grupet e interesit, përmes një ekspozite dhe prezantimi në takimin plenar, në mënyrë aktive dhe me shumë fantazi, promovuan propozimet e tyre tematike.

Nga diskutimi për të ardhmen lindi edhe «tema-fanar», e cila është bërë moto e Kongresit 2016: «Solidar në shoqëri – të fortë në ndërmarrje».

Programi

E enjte, 27 tetor

Prej 13.00	Regjistrimi i delegatëve dhe mysafirëve
14.00	Hapja e Kongresit, përshëndetjet, konstituimi, rregullorja e punës, programi, procesverballi i Kongresit 2012, nderimi i të vdekurve
14.40	Raporti i punës 2012-16, retrospektivë me një film të shkurtër Shembull suksesi FAR, industria e ndërtimit Rezoluta për forcimin e të drejtave të punëmarrësve/ Raporti me BE Shembull suksesi, kontrolli i pagave në Gjenevë

rreth 15.30	Fjalim i Ministrisë Burkhalter Rezoluta për ofenzivën e natyralizimit/politika për refugjatët Raporti i rishikimit për solidaritetin me refugjatët Zgjedhja e Drejtorisë: Numri i anëtarëve të Drejtorisë Ndryshimet statutore
--------------------	---

17.00	Dalja në Place Neuve/Aksion
Prej 18.30	Darka, Program i rajoneve

E premte, 28 tetor

08.15	Strategjia organizative
11.15	Fjalim i Paul Rechsteiner, Kryetar i SGB/USS
11.30	Rezoluta për sigurinë sociale Shembull suksesi, pensionimi i parakohshëm i bojxhinjëve dhe salvatuesve
12.00	Pauza e drekës
13.00	Vazhdim: Strategjia organizative Shembull suksesi, greva në Exten

Rreth 15.25	Fjalim i Ressie Fos, përfaqësues i punëtorëve të ndërtimit për kampionatin botëror të futbollit në Katar
--------------------	--

15.45	Zgjedhja e Drejtorisë dhe e Kryesisë Qendrore Vazhdim: Strategjia organizative Fjalimi paszgjedhor i Kryetares Përshëndetja dhe miratimi i tërheqjes së anëtarëve të Drejtorisë
--------------	--

18.15	Përfundimi i ditës së dytë të Kongresit
--------------	---

E shtunë, 29 tetor

8.10	Vazhdim: strategjia organizative
Në ndërkohë	Shembull suksesi, demonstrata e grave Rezolutë për orarin e punës/pajtueshmëria profesioni/familja

11.20	Fjalim i Philipp Jennings, Sekretar i Përgjithshëm i UNI Global Rezolutë: Një ekonomi tjetër është e nevojshme/digjitalizimi Shembull suksesi: Lufta e shoferëve të taksive kundër Uber Rezoluta të tjera
--------------	--

12.30	Përfundimi i Kongresit
--------------	------------------------

E shtunë, 3 dhjetor, Bern

Vazhdim i punës me të gjithë delegatët e Kongresit në kuadër të Kuvendit të rregullt të Unia

- Diskutime dhe dokumentet për pozicionimet
- Kërkesa dhe propozime të përgjithshme
- Kërkesa dhe propozime për rregulloret.

Kongresi 2016 në Gjenevë

Kongresi i Unia përcakton kursin

Kongresi është organi më i lartë i Unia. Ai do të trasojë rrugën për punën sindikale në vitet e ardhshme.

Në fund të Tetorit, 400 delegatët e kongresit në Gjenevë do të bëjnë bilancin e katër viteve të kaluara dhe do të përcaktojnë strategjinë organizative për periudhën deri në kongresin e ardhshëm. Përveç kësaj, ata/ato do të zgjedhin anëtarët e Drejtorisë dhe të Kryesisë Qendrore.

Strategjia organizative përcakton kahen

Strategjia organizative përcakton qëllimet e përbashkëta, të cilat synon t'i arrijë Unia në katër vjetet e ardhshëm. Strategjia është e ndarë në tetë fusha të veprimit. Këto tetë fusha të veprimit janë: (1) Rritja e anëtarësisë, (2) anëtarët aktivë, (3) kujdesi ndaj anëtarëve, (4) aftësia e mobilizimit sindikal, (5) marrëdhëniet e punës kolektive, (6) ndikimi politik, (7) arka e papunësisë, dhe (8) organizata profesionale. Për çdo fushë të veprimit do të definojnë qëllime dhe kriteret të qarta, me arrijen e të cilave do të mund të matet Unia. Strategjia e propozuar nga Kryesia Qendrore është diskutuar gjerë e gjatë në organet e Unia nëpër rajone, sektorë dhe në grupet nacionale të interesit. Nga kjo kanë rezultuar 140 parashtrës për ndryshime për Kongresin. Diskutimi në lidhje me këto ndryshime në Gjenevë do të marrë më së shumti kohë. Veç kësaj, delegatët do të miratojnë një varg rezolutash për temat aktuale dhe do të zgjedhin anëtarët e Drejtorisë dhe të Kryesisë Qendrore (shih programin në korniza).

Një ditë shtesë në Kongres për pozicionimin tematik

Edhe me këtë, Kongresi ende nuk e ka kryer punën e vet. Në pjesën e dytë, ai do të diskutojë dhe vendosë për pozicionimin për temat kryesore, për të cilat do të përcaktohet Unia në ballafaqimet shoqërore. Po ashtu, me këtë rast – respektivisht në lidhje me katër pozicionimet tematike të elaboruara nga Drejtoria dhe të miratuara nga Kryesia Qendrore - janë pranuar jo më pak se 129 kërkesa e parashtrës. Ato do të diskutohen (në një ditë shtesë të jashtëzakonshme të Kongresit) më 3 dhjetor në Bern, në mënyrë që të mundësohet kohë e mjaftueshme për një diskutim demokratik.

Pozicionimet tematike trasojnë fundamentin përmbajtësor për punën tonë në vitet e ardhshme dhe formulojnë kërkesat konkrete në katër fusha tematike:

■ **Barazia sociale dhe siguria:** E drejta themelore për një ekzistencë njerëzore dinjitoze, pjesëmarrja e barabartë në shanset jetësore të një shoqërie demokratike dhe solidariteti me njerëzit në nevojë, janë vlerat qendrore të lëvizjes sindikale.

■ **Mbrojtje më e madhe dhe të drejta të barabarta:** Çdo punëmarrës, pa marrë parasysh prejaridhjen e tij/saj, ka të drejtë për kushte të drejta të punës, për trajtim dinjitoz dhe për respektim. Prandaj, lufta solidare për të drejta të barabarta kundër plaçkitjes dhe diskriminimit, është në qendër të lëvizjes sindikale.

■ **Punë e mirë për një jetë më të mirë:** Kushtet e mira të punës, një shpërndarje e drejtë e punës



dhe e kushteve shoqërore, të cilat mundësojnë një pajtueshmëri midis punës dhe jetës private, janë në qendër të politikës sindikale.

■ **Një ekonomi tjetër është e mundshme:** Solidariteti sindikal nuk përfundon në kufinj të vendit. Me angazhimin tonë për një ekonomi të drejtë dhe një përparim teknologjik, i cili vë në qendër të vëmendjes nevojat e punëmarrësve, ne duam të mundësojmë një jetë më të mirë për të gjithë njerëzit e planetit tonë.

Impulset për realizimin e strategjisë

Po ashtu, në ditën shtesë të jashtëzakonshme të Kongresit, në kuadër të diskutimit mbi ardhmërinë, delegatët do të diskutojnë edhe për projekt-propozimet udhërrëfyese, të cilat duhet të trajtohen menjëherë pas Kongresit, me rastin e përpunimit të masave për zbatim.

Kongresi zgjedh udhëheqjen e re

Në frymën e vazhdimësisë

Një detyrë e rëndësishme e Kongresit është dhe zgjedhja e organeve drejtuese, Kryesisë Qendrore dhe Drejtorinë. Është propozuar një zvogëlim i Drejtorisë në shtatë anëtarë.

Zgjedhja e organeve bëhet në tre hapa. Së pari delegatët e Kongresit përcaktojnë numrin e anëtarëve të Drejtorisë. Sipas statutit, më së paku janë shtatë dhe më së shumti nëntë. Kryesia Qendrore ka propozuar, për periudhën e ardhshme midis kongreseve, zvogëlimin nga nëntë në shtatë anëtarë të Drejtorisë dhe për të mos plotësuar dy anëtarët që janë tërhequr. Një të tretën e tyre, sipas statutit, duhet të jenë femra; prej shtatë anëtarëve, së paku tri.

Pastaj delegatët zgjedhin Kryesinë, udhëheqësit/set e sektorëve, shefin e financave dhe anëtarët e tjerë të Drejtorisë. Si kryetare është propozuar sërish Vania Alleva, ndërsa si zëvendëskryetarë janë propozuar zëvendëskryetarët e tashëm Aldo Ferrari dhe Martin Tanner. Si udhëheqës dhe udhëheqëse të sektoreve, kuvendet respektive kanë nominuar për rizgjedhje po ashtu udhëheqësit/set e deritanishme: Vania Alleva për sektorin terciar, Aldo Ferrari për tregtinë, Corrado Pardini për Industrinë dhe Nico Lutz për ndërtimin. Për shef të financave është kandiduar Martin Tanner (i deritashëm), ndërsa edhe të dy anëtarët e Drejtorisë, Corinne Schärer dhe Véronique Polito janë kandiduar përsëri.

Në fund, Kongresi zgjedh Kryesinë Qendrore. Janë propozuar 49 persona, nga ta 22 femra (anëtarë të Drejtorisë, sekretarë gjegjësisht sekretarë rajonale, të deleguar të sektoreve dhe të grupeve të interesit, udhëheqës të arkës së papunësisë).

Nga Drejtoria e deritanishme nuk kandidojnë më Rita Schiavi (ajo do të pensionohet në fillim të vitit 2017) dhe Pierluigi Fedele (që nga pranvera e vitit 2016 është sekretar rajonal në Transjuranë).



Vania Alleva 1969, shtetase e dyfishtë zvicerano-italiane

«Bashkërisht mund të arrijmë barazinë e mundësive dhe mosdiskriminimin dhe kështu të mundësojmë një jetë dhe punë të dinjitetshme.»

Arsimimi: Studimet në Universitetin e Romës, studimet postdiplomike në komunikimin ndërkulturor
Profesioni: punë të ndryshme, ndër të tjera si arkëtare, gazetare, mësimdhënëse. Prej vitit 1997 në Unia, respektivisht në sindikatën pararendëse GBI, me detyra të ndryshme drejtuese. Prej vitit 2008 anëtare e Drejtorisë së Unia dhe udhëheqëse e sektorit terciar, prej vitit 2012 Bashkëkryetare, prej vitit 2015 Kryetare e Unia.

Unë jam për një Unia

- për të cilën kushtet e drejta të punës dhe siguria sociale janë temë bosht për të gjithë,
- që është e pranishme në botën e punës, por edhe në shoqëri e politikë dhe ka ndikim vendimtar.



Martin Tanner 1967

«Nëse të gjithë së bashku tërheqin të njëjtin litër, ne mund të përbushim qëllimet dhe pritjet e larta.»

Arsimimi: Mësimdhënësi i ekonomisë së ndërmarrjes, shkolla e lartë profesionale

Profesioni: Zanati dhe punë në Institucionin Kreditor Zviceran (Schweiz. Kreditanstalt) dhe në Klubi Bankar të Zvicrës (Schweiz. Bankverein), prej vitit 1996 në departamentin e trustit pranë administratës për menaxhimin e pronës në Unia – Zivag, prej vitit 2000 udhëheqës i departamentit financiar SMUV respektivisht Unia, prej vitit 2012 anëtar i Drejtorisë së Unia, prej vitit 2015 Zëvendëskryetar i Unia.

Unë jam për një Unia

- me financa të shëndosha, në mënyrë që të mund të investohet në projektet e orientuara në ardhmëri dhe për t'u armatosur për luftërat e punës,
- të shumëllojshme në aspektin kulturor, gjuhësor e tjera dhe me këtë rast nuk harron se vetëm zgjidhjet e përbashkëta vazhdojnë të na mbajnë si një forcë të madhe.

Në lëvizje për një sindikatë pjesëmarrëse

Me «Strategjinë e Unia 2013–2016», më 2012 Kongresi ka përcaktuar nëntë qëllime ambicioze strategjike. Rajonet, katër sektorët dhe grupet e interesit, mbi këtë bazë kanë formuluar strategjitë ndërtuese dhe kanë zbatuar masat respektive.

Kongresi ka mishëruar qëllimet strategjike në një vizion afatgjatë. Me të ashtuqajturat «Yjet fikse», delegatët kanë përcaktuar orientimin parimor të Unia. Ata e definuan atë si organizatë të njerëzve të varur nga pagat, e cila e ndryshon raportin e forcave midis kapitalit dhe punës në të mirë të punëmarrësve, që synon një shpërndarje më të drejtë në botë dhe siguron respektimin e të drejtave të njeriut dhe të drejtave themelore.

Qëllimet strategjike

Në këtë kuptim janë definuar nëntë qëllime strategjike: (1) Ndikimi përmes anëtarëve aktivë, (2) një raport më i mirë i forcave përmes mobilizimit dhe aftësisë për greva, (3) mbrojtje përmes zhvillimit të mëturshëm të KPP, forcimi i masave mbrojtëse dhe mbrojtja e të arriturave në Ligjin e punës, (4) forcimi përmes rritjes së anëtarësisë, (5) përparim përmes politikës aktive sociale dhe ekonomike, (6) përmirësim i pozitës së migrantëve/eve, (7) angazhimi sindikal ndërkombëtar, (8) funksionimi profesional dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve dhe (9) kërkesat e bashkëpunësuesve.

Këtyre qëllimeve strategjike u janë përshtatur gjithsej 55 qëllime të kongresit dhe masa të hollësishme implementuese. Për përmbushjen e tyre Drejtoria i paraqiti Kuvendit të përfaqësuesve një raport të hollësishëm në verë të vitit 2016. Bilanci i hollësishëm mund të gjendet në raportin e punës së Unia për periudhën 2012–2016.

Përparimet e matshme

Unia ka bërë shumë gjëra të mira në vitet e kaluara. Ajo është rritur dukshëm dhe ka tejkaluar prapë e 200 000 anëtarëve. Mundësitë e pjesëmarrjes së anëtarëve janë përmirësuar dhe një numër i madh i njerëzve të besueshëm është angazhuar në mënyrë aktive në diskutimin për ardhmërinë. Unia së bashku me anëtarët dhe njerëzit e besueshëm zhvillon aftësitë e veta, metodat dhe proceset në mënyrë dinamike në vazhdimësi edhe mëtej dhe në aspektin financiar qëndron në këmbë stabile. Ajo mund të krenohet me të drejtë për këtë.

Konkretisht, Unia ka arritur të mbrojë Kontratën e Përgjithshme të Punës ekzistuese. Fushata për KPK në vjeshtë të vitit 2015, dëshmoi në mënyrë të qartë aftësinë mobilizuese të sindikatës sonë. Edhe KPK më e madhe numerike në Zvicër, KPP-K e hotelierisë, ka mundur të ripërtërihet me disa përmirësime në vitin 2016. Me KPK për shitorë në pikat e karburanteve, Unia ka arritur për herë të parë një KPK kombëtare për tregtinë me pakicë.

Angazhimi konsekuent

Unia ka kundërshtuar në mënyrë konsekuente sulmet ndaj arritjeve sociale dhe kushteve të punës. Me fushatën për pagat minimale, prag prej 4000 Franka për muaj është përcaktuar si vlerë referuese për bisedimet mbi pagat.

Me rastin e votimeve për Ecopop dhe për «iniciativën zbatuese» («Durchsetzungsinitiative») Unia është angazhuar në mënyrë të suksesshme për një shoqëri të hapur. Në anën tjetër, me miratimin e «Iniciativës për imigrimin masiv» («Masseneinwanderungsinitiative»), pikërisht në politikën e migracionit ka përjetuar një goditje të dhembshme. Nga kjo është dëmtuar drejtpërdrejtë Unia, e cila ka në gjirin e vetë njerëz të mbi 180 nacionaliteteve. Në diskutimin për zbatimin e saj, Unia e mbron lirinë e lëvizjes së njerëzve dhe forcimin e masave mbrojtëse respektive, për mbrojtjen e pagave dhe të kushteve të punës: Punëmarrësit nuk guxojnë të manipulojnë kundër njëri-tjetrit. Diskriminimi, kontingjentet apo qoftë edhe një status i ri për sezonierë, nuk janë të pranueshme.



Çfarë na lëvizë ne

Raporti i punës i Unia 2012–2016 bën bilancin për katër vjetët e kaluara.

Ky libër i fortë 120 faqësh prezanton me fotografi të shumta, tabela dhe tekste nxitëse, angazhimin e Unia në katër vjetët e kaluara. E pasqyron angazhimin e madh të anëtarëve tanë dhe dokumenton aktivitetet e sindikatës më të madhe në Zvicër.

Raporti i punës ofron një mori të dhënash dhe material numerik, për zhvillimin e sektorëve dhe degëve të veçanta, për punën e 14 rajoneve të Unia, të grupeve të interesit dhe të arkës për të papunët, si dhe për zhvillimin e anëtarësisë.

Raporti i punës, për atë që është në dispozicion, mund të porositet në: info@unia.ch

Aldo Ferrari 1962, një vajzë, shtetas i dyfishtë zvicerano-italian
«Kush lufton, mund të humbë. Kush frikësohet ... humb që më parë!»

Arsimimi: Elektromekanik, Certifikata Federale e Aftësisë si ekspert i sigurimeve sociale
Profesioni: Elektromekanik, vozitës në transportin publik, prej vitit 1996 Sekretar i sindikatës në GBI, në vitet 2000–2011 sekretar rajonal, prej vitit 2011 anëtar i Drejtorisë dhe udhëheqës i sektorit të tregtisë në Unia, prej vitit 2012 Kryetar në Fondacionin e arkës së pensioneve në Unia, prej vitit 2015 Zëvendëskryetar i Unia.

Unë jam për një Unia

- demokratike dhe të hapur,
- e cila bashkë me anëtarët e saj është për një shpërndarje më të mirë të pasurisë, si parakusht për vetë-realizimin individual dhe kolektiv të njerëzve.

Nico Lutz 1970, tre fëmijë
«Vetëm me një Unia të fortë dhe luftarake ne mund të pengojmë që të pasurit të pasurohen edhe më shumë dhe që punëtorët të paguajnë për këtë.»

Arsimimi: Studimi i shkencave politike dhe planifikimit të trafikut
Profesioni: Mbi 20 vjet në aktivitet sindikal; prej vitit 1993 në GBI, 1999–2004 si sekretar i VPOD, 2005–2012 bashkë-udhëheqës i departamentit për komunikim dhe fushata i Unia, prej vitit 2012 anëtar i Drejtorisë dhe udhëheqës i sektorit të ndërtimitarisë në Unia.

Unë jam për një Unia

- të mishëruar në ndërmarrje dhe që bartet nga njerëzit e besueshëm e të angazhuar,
- ku të gjithë tërheqin të njëjtin litar, dhe atë në të njëjtën anë.

Corrado Pardini 1965, shtetas i dyfishtë zvicerano-italian
«E fortë dhe e besueshme është Unia, nëse anëtarët dhe njerëzit tanë të besueshëm vërtetë mund të bashkëvendosin në çështjet e rëndësishme.»

Arsimimi: Zanati si makinist, gjimnazi ekonomik, studime të diplomës për menaxhim të asociacioneve
Profesioni: Prej vitit 1987 sekretar i sindikatës GBH/GBI/Unia, prej vitit 2008 anëtar i Drejtorisë së Unia dhe udhëheqës i sektorit të industrisë, prej vitit 2011 deputet i Parlamentit Kombëtar, prej vitit 2006 Kryetar i Lidhjes së Sindikatave të Kantonit të Bernit.

Unë jam për një Unia

- që është e fuqishme dhe e cila bisedon me punëdhënësit si partner i barabartë në nivel të njëjtë,
- që angazhohet për Zvicrën si vendpunishte të fuqishme, falë arsimimit dhe ngritjes së mëtejshme, për rindërtimin ekologjik dhe për një politikë industriale aktive.

Véronique Polito 1977, dy fëmijë, shtetase e dyfishtë zvicerano-italiane
«Puna sindikale kërkon qëndrueshmëri. Prandaj solidariteti është i rëndësishëm. Sepse ne mund të përparojmë, vetëm nëse ne jemi të bashkuar.»

Arsimimi: Studimet për shkencat sociale, studimet post-diplomike për ekonomi të ndërmarrjes
Profesioni: Këshilltare sociale në organizatën për azilin dhe koordinatore e projekteve integruese pranë Organizatës Zvicerane për Refugjatë (SFH/OSAR), prej vitit 2007 deri 2011 sekretare politike në Sekretariatën Qendror të Unia, prej 2011 deri 2015 Sekretare e Përgjithshme në Lidhjen e Sindikatave Zvicerane, prej vitit 2015 anëtare e Drejtorisë së Unia dhe udhëheqëse e sektionit terciar.

Unë jam për një Unia

- që angazhohet për një botë njerëzore të punës, ku femrat dhe meshkujt trajtohen me respekt dhe në mënyrë të dinjitetshme,
- që është e bindur, e vendosur dhe vazhdimisht mbron vlerat dhe solidaritetin.

Corinne Schärer 1964, tre fëmijë
«Vjedhje pensionesh, zbritje pagash, paga të ulëta për gratë – botë e përmbysur. Me një Unia të fortë, ne të gjitha këto do t'i kthejmë mbarë.»

Arsimimi: Studimet në histori dhe gjuhë angleze, ngritje të ndryshme të mëvonshme
Profesioni: Mësimdhënëse në shkollë të mesme, prej vitit 1994 aktive në sindikatë: Sekretare e sektionit në VPOD, sekretare e përgjithshme në Unia të vogël, sekretare rajonale në VPOD, prej vitit 2009 udhëheqëse e departamentit për kontrata dhe politika të interesit në Unia, prej vitit 2012 anëtare e Drejtorisë në Unia.

Unë jam për një Unia

- që angazhohet shumë për paga të dinjitetshme, për barazi pagash dhe për pajtueshmëri midis profesionit dhe familjes,
- që lufton për një mbrojtje të fortë kundër largimit nga puna, që i mbron punëmarrësit nga arbitrariteti i punëdhënësve.

Ne jemi Unia

Unia, këta janë mbi 200 000 anëtarët e saj. Demonstrata të shumta, aksione, greva dhe puna e përditshme në bazë nëpër ndërmarrje, përbëjnë sindikatën e fortë. Kjo faqe pasqyron disa pika kulmore të viteve 2012–2016.

3 prill 2013 Rreth 100 aktivistë/e shtrajnë kërkesën për referendum kundër ditës 24 orëshe të punës. «Aleanca e së dielës» ka grumbulluar 86'499 nënshkrime të rëndësishme, mbi gjysma prej tyre janë mbledhur nga Unia.



31 gush 2013 «Ne e thyejmë kufirin e katërmijëve»: Një grup i sindikalisteve/ëve të ushtruar për ngjitje arrin majen e Bishorn (4153 metra mbi nivelin e detit) dhe me panon e majëmalit bën reklamë për iniciativën e pagës minimale.



21 shtator 2013 Mbi 15 000 sindikaliste/ë në Bern kanë dalur në rrugë, për të demonstruar për një mbrojtje më të mirë të pagave dhe të pensioneve.



1. nëntor 2014 Rreth 8000 njerëz demonstruan, në një tubim paqësor dhe shumëngjyrësh, në Sheshin Federal kundër Ecopop-Initiativës. Bashkëkryetarja e Unia Vania Alleva, tregon për rrezikun e kësaj iniciative.



6. janar 2015 Fushata për pagën minimale jep frytet e veta në shumë ndërmarrje. Kështu në H&M, atje personeli që nga fillimi i vitit 2015 fiton së paku 22 Fr./për orë. Në shenjë falënderimi për shitëset/it, Unia shpërndan kurora dhe ëmbëlsira në filialet e H&M.



7. shkurt 2015 Rreth 250 persona marrin pjesë në Kongresin e parë për migrantët në Bern. Ata kërkojnë, midis tjerash, vazhdimin e lirisë së lëvizjes së personave me BE dhe parakushte të njëjta në tregun e punës.



20. shkurt 2015 Të 100 të punësuarit e ndërmarrjes Exten SA në Mendrisio (TI) hyjnë në grevë. Ata kundërshtojnë zbritjen masive të pagave, të cilën synon ta realizojë ndërmarrja me arsyetimin e forcimit të Frankut zvicerian. Pas një javë grevë, ndërmarrja dorëzohet dhe e tërheq vendimin për zbritjen e pagave, së paku përkohësisht.



7. mars 2015 Mbi 12000 persona demonstrojnë në Bern për barazinë e pagave. Edhe sot gratë fitojnë rreth 20% më pak se burrat për punë të njëjtë – megjithëse ekziston Ligji për barazi!



5. qershor 2015 Delegatët e Unia nga industria protestojnë para Bankës Kombëtare dhe kërkojnë nga Drejtoria e BKZ (SNB/BNS), një kurs ndërrimi për Euron, i cili siguron mbijetesën e mëtutjeshme të Zvicrës si vend industrial.



27. qershor 2015 Mbi 15000 punëtorë të ndërtimtarisë nga e tërë Zvicra demonstrojnë në Cyrih për një KPK dhe për mbrojtjen e pensionimit me 60 vjet. Ata kërkojnë nga pronarët ndërtimtarë që të ndërprejnë bllokadën e tyre të bisedimeve.



9.–11. nëntor 2015 Mbi 10000 punëtorë të ndërtimtarisë në tërë Zvicrën ndërprejnë punën e tyre dhe kërkojnë, në protestat e tyre gjithditore, sigurimin e pensionit me 60 vjet. Angazhimi i tyre del i suksesshëm: Në dhjetor pronarët ndërtimtarë dorëzohen, pensionimi i mëhershëm i moshës me 60 vjet mbetet.



3. maj 2016 Sindikatat dhe SMGV janë pajtuar: pas përpjekjeve shumëvjeçare, bojahitë dhe salvatuesit në Zvicrën gjermane, në Jura dhe bohaxhitë në Tesin, që në të ardhmen të pensionohen në moshën 60 vjeçare.



17. maj 2016 Shoferët/et e taksive nga Gjeneva, Lozana, Bazeli dhe Cyrihu, përmes një aksioni të koordinuar, kërkojnë ndalimin e damping-shërbimit të vozitjes Uber, përderisa ky nuk u përmbahet ligjeve të Zvicrës.



6. qershor 2016 Me rastin e konferencës së Unia për degën e kujdesit, 60 delegatë të Kongresit i dërgojnë Këshillit Federal një rezolutë. Ata kërkojnë një përmirësim të kushteve të punës dhe perspektiva më të mira afatgjata.



Verë 2016 Me aksione të shumta në tërë Zvicrën, anëtarët e Unia bëjnë reklama për iniciativën popullore (referendumin) AHV/AVSplus, e cila kërkon një përmirësim të pensioneve të AHV/AVS.



10. shtator 2016 Mbi 20000 persona – të rinj dhe të moshuar, të punësuar, pensioniste dhe pensionistë – marshojnë në rrugët e Bernit. Ata dërgojnë një sinjal të fortë kundër zbritjes së pensioneve dhe për forcimin e AHV/AVS.

